



# KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

---

RAPORTI VJETOR

2011

# PËRMBAJTJA

---

AKRONIMET .....	3
FJALA HYRËSE.....	4
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS .....	5
KOMISIONET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS.....	6
KOMISIONI DISIPLINOR .....	7
STRUKTURA ORGANIZATIVE E KËSHILLIT .....	8
SEKRETARIATI I KËSHILLIT .....	8
ÇËSHTJET E PERSONELIT DHE TË ADMINISTRATËS SË SEKRETARIATIT .....	8
BUXHETI DHE FINANCA .....	9
BUXHETI I VITIT 2011 .....	10
RAPORTI I SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT NË VITIN 2011 .....	10
PROJEKTET TJERA DHE BASHKËRENDIMI ME DONATORË .....	12
ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR.....	12
NJËSIA PËR SHQYRTIMIN E PERFORMANCËS GJYQËSORE.....	13
PROCESI I EMËRIMIT TË GJYQTARËVE .....	14
STRATEGJIA SHPETËRORE PËR REDUKTIMIN E LËNDËVE TË VJETRA.....	16
STRUKTURA E GJYKATAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS .....	20
GJENDJA ME LËNDË NË GJYKATA.....	25

# AKRONIMET

Këshilli	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KD	Komisioni Disiplinor
SKGJK	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
NJSHPGJ	Njësia e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore
ZVV	Zyra për Vlerësim e Verifikim
GJS	Gjykata Supreme
GjQ	Gjykata e Qarkut
GJK	Gjykata Komunale
GjE	Gjykata Ekonomike
GjKK	Gjykata Komunale për Kundërvajtje
BF	Buxheti dhe Financa
AP	Administrata dhe Personeli
TIK	Teknologji Informative dhe Komunikim
KE	Komisioni Evropian
MD	Ministria e Drejtësisë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
EROL	Programi i USAID për Sundim Efektiv të Ligjit
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave

---

## FJALA HYRËSE

Kam nderin ta paraqes Raportin e Punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011. Ky raport përfshin zhvillimet e përgjithshme në gjyqësorin e Kosovës, duke filluar nga aktivitetet e Këshillit, vendimet, procesi i emërimit të gjyqtarëve, strategjia shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra, nxjerrja dhe zbatimi i rregulloreve dhe akteve tjera, procesi i zbatimit të ligjit të ri për gjykata, komisioni disiplinor, misioni i tij dhe përbërja, çështjet e buxhetit dhe personelit, si dhe statistikat e gjykatave.

Këshilli, i kushton vëmendje të posaçme informimit të publikut të gjerë, sikurse edhe çdo detyre tjetër, duke e konsideruar se qytetarët e informuar dhe aktivë, mund të kontribuojnë në përpjekjet e përbashkëta institucionale dhe civile në krijimin e një sistemi të besueshëm të drejtësisë, transparent, llogaridhënës dhe në rritjen e besimit të publikut në punën e gjykatave në përgjithësi.

Veprimtaria e Këshillit në vitin 2011 është përqendruar në procesin e reformave në tërë sistemin, me qëllim të krijimit të standardeve të sinkronizuara me standardet më të mira evropiane. Pikërisht në këtë drejtim është krijuar një kuadër ligjor, cilësor e bashkëkohor, të cilin Këshilli është i angazhuar të garantojë, të sigurojë dhe të krijojë kushte për zhvillimin e një drejtësie efektive, përmes një sistemi gjyqësor profesional, të paanshëm e të pavarur nga çdo lloj ndikimi politik.

Këshilli është i përkushtuar dhe do të vazhdojë të punojë e të angazhohet në krijimin e një gjyqësori funksional, të pavarur dhe transparent dhe njëkohësisht të krijojë kushte më të përshtatshme për punë, përmirësim dhe tejkalimin e të gjitha sfidave, të cilat po e përcjellin gjyqësorin kosovar në përgjithësi.

Këshilli udhëhiqet nga synimi dhe misioni se vetëm së bashku do të arrijmë rezultatet dhe objektivat e synuara.

Ju faleminderit,

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës  
Enver Peci

# KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

---

Kompetencat e Këshillit janë të parapara me Kushtetutë dhe Ligjin për Këshillin, në bazë të të cilave Këshilli ka rolin fundamental për sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor. Në këtë kuadër, funksionet e Këshillit përfshijnë procedurat për rekrutim, emërim, riemërim, transferim, disiplinë, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve laikë; në menaxhim dhe administrim të gjykatave, në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit dhe në themelimin e gjykatave dhe degëve të reja.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion kushtetues i themeluar në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe përbën institucionin më të lartë të gjyqësorit në Kosovë.**

Duke u bazuar në Kushtetutë, mandati i anëtarëve të Këshillit është mandat pesë vjeçar (5), me vetëm një mundësi rizgjedhjeje. Këshilli sipas kushtetutës i ka gjithsej 13 anëtarë: tetë anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa pesë anëtarë vijnë drejtpërdrejtë nga gjyqësori. Këshilli aktualisht ka 12 anëtarë, nga të cilët pesë janë të nacionalitetit shqiptar, pesë të nacionaliteteve tjera dhe dy janë ndërkombëtarë (pasi që këtë e përcaktojnë dispozitat kalimtare të Kushtetutës së Kosovës). Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit me kuorumin që është i paraparë me ligj prej nëntë (9) anëtarëve. Në kuadër të Këshillit është Sekretariati që ndihmon Këshillin në zbatimin e rregullave dhe politikave të Këshillit lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e gjykatave. Në kuadër të Këshillit veprojnë edhe Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore (NJSHPGJ) dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD). Po ashtu, për të mbështetur procesin e emërimit të gjyqtarëve është themeluar edhe Zyra për Vlerësim dhe Verifikim të Gjyqtarëve (ZVVGJ).

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe të Ligjit për Gjykatat, u vunë themelet e një strukture të re organizative të gjyqësorit, si dhe u vendosën premisat mbi të cilat ndërtohet një gjyqësor i pavarur i cili administrohet nga vetë profesionistët e gjyqësorit. Për më tepër, edhe pozita materiale e gjyqtarëve u përmirësua deri në nivelin ku gjyqtari mund të bëjë një jetë dinjitoze me të hyrat nga puna e tij. Çështjet e emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve, kohëzgjatja e mandatit të tyre, vlerësimi i performancës së tyre, trajnimet gjyqësore, avancimi në detyrë, etika profesionale, disiplinimi, administrimi gjyqësor dhe menaxhmenti, buxheti i gjyqësorit, të gjitha këto janë kritere bazë që garantojnë pavarësinë e gjyqësorit në proces të rregullimit ose vetëm kanë gjetur vend në dispozitat ligjore nën mbikëqyrjen e Këshillit. Përmes këtyre instrumenteve kushtetuese dhe ligjore, pozita e gjyqësorit është fuqizuar, është vënë në vendin e merituar, në të njëjtin nivel me dy pushtetet tjera.

Gjatë vitit 2011 Këshilli ka mbajtur gjithsej dymbëdhjetë mbledhje. Sfidë për Këshillin, gjatë kësaj periudhe ka qenë dhe mbetet buxheti i limituar për gjyqësorin, i cili për vitin 2011 ka qenë 17,000,892 €.

Për vitin 2012 Këshilli ka kërkuar 21 milionë, ndërsa janë miratuar 19 milionë. Dihet se për të zbatuar në tërësi Ligjin për Gjykatat dhe për të siguruar një tranzicion të lehtë në strukturë të re gjyqësore nevojitet edhe buxhet shtesë, duke pasur parasysh se Ligji i ri për Gjykatat themelon Departamente për Krime të Rënda, në dy komuna që nuk kanë pasur në kompetencë territoriale vepra të tilla gjyqësore (Ferizaj dhe Gjakovë), kur themelon një degë tërësisht të re siç është ajo në Novo Bërdë, por edhe kur do të ketë nevoja të shumta sa i përket aktiviteteve tjera në funksion të implementimit të ligjit të ri për gjykata. Për më tepër, buxhet shtesë nevojitet edhe për zbatimin e Ligjit të ri për Dhomën e Posaçme.

Gjithashtu, numri i madh i lëndëve të grumbulluara në gjykatat e Kosovës mbetet sfida e cila është duke na përcjellë me vite, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për ta zvogëluar numrin e këtyre lëndëve.

Në disa nga të arriturat e Këshillit për vitin 2011 llogaritet edhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke përfshirë edhe minoritetet, gjyqtarët e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe gjyqtarët e gjykatave të qarkut. Po ashtu, Këshilli ka miratuar një sërë rregulloresh që dalin nga pakoja e ligjeve për Këshillin dhe gjykatat. Vlen të theksohet edhe niveli i lartë i bashkëpunimit me akterët nga bashkësitë ndërkombëtare, siç janë: Komisioni Evropian, USAID-i, EUELX, Qeveria Norvegjeze, etj.

Disa nga rregulloret e miratuara nga Këshilli janë Rregullorja për procesin e emërimit të gjyqtarëve dhe Rregullorja për caktimin e normës së gjyqtarëve.

## **KOMISIONET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS**

Këshilli, në kuadër të tij, ka katër komisione, siç janë:

- Komisioni Disiplinor,
- Komisioni për Çështje Normative,
- Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel dhe
- Komisioni për Administrimin e Gjykatave.

Komisionet janë themeluar për të mbështetur Këshillin në ushtrimin e autoritetit të tij, secili komision ka më së paku tre anëtarë, të cilët Këshilli i zgjedh me mandat të kufizuar. Komisionet kanë kryetarin i cili zgjedhet nga radhët e anëtarëve të komisionit. Komisionet i përcaktojnë detyrat specifike dhe prioritetet dhe i propozojnë Këshillit miratimin e tyre. Për çështjet për të cilat nuk është i nevojshëm miratimi i Këshillit, komisionet vendosin me shumicën e votave të anëtarëve prezentë në mbledhje.

Këshilli, sipas nevojës, mund të themelojë edhe komisione të tjera të përkohshme ose të përhershme.

## KOMISIONI DISIPLINOR

Komisioni Disiplinor, siç është përcaktuar me dispozitat pozitive në fuqi, formohet me qëllim të inicimit dhe zgjedhjes në shkallë të parë të rasteve të shkeljeve nga gjyqtarët dhe gjyqtarët laikë dhe me qëllim të shqiptimit të sanksioneve të duhura me rastin e vërtetimit të shkeljes.

Me nenin 33 deri te neni 42 të Ligjit për Këshillin është paraparë puna e Komisionit Disiplinor. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të Këshillit, dy (2) nga të cilët duhet të jenë gjyqtarë, derisa Kryesuesi i komisionit gjithsesi duhet të jetë gjyqtar.

Komisioni Disiplinor i Këshillit në vitin 2011 ka mbajtur gjithsej 12 seanca disiplinore. Në këto seanca disiplinore janë shqyrtuar gjithsej 63 raporte përfundimtare të ZPD-së me të cilat ngarkohen gjyqtarët për sjellje të pahijshme.

Me rastin e shqyrtimit të këtyre raporteve, në seancat e cekura më lart, janë marrë 57 vendime, në të cilat janë shqiptuar këto masa:

- Ndërprerje të procedurës disiplinore për shkak se tani këta gjyqtarë nuk janë në sistemin gjyqësor (15 vendime);
- Pushim të procedurës për shkak të vdekjes së gjyqtarëve (2 vendime);
- Masa disiplinore Qortim (19 vendime);
- Masa disiplinore Qortim dhe Vërejtje (një vendim),
- Ulje e pagës në 50 % për dy muaj (një vendim),
- Lirim nga përgjegjësia disiplinore (20 vendime),
- Refuzim kërkesë për suspendim (një vendim), dhe
- Katër vendime me të cilat gjyqtarët janë liruar nga përgjegjësia pasi që ata nuk janë pjesë e sistemit gjyqësor, edhe pse Komisioni Disiplinor ka konstatuar sjelljet e pahijshme të pretenduara nga ana e Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

# STRUKTURA ORGANIZATIVE E KËSHILLIT

---

Këshilli po ashtu ka tre njësi organizative të brendshme:

- Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës,
- Zyra e Prokurorit Disiplinor, (e cila njëkohësisht i përgjigjet edhe Këshillit Prokurorial të Kosovës), dhe
- Njësia e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore.

## SEKRETARIATI I KËSHILLIT

E gjithë puna dhe funksionimi i Këshillit mbështetet nga Sekretariati i Këshillit, të cilin e udhëheq drejtori i Sekretariatit, që zgjidhet nga Këshilli. Sekretariati i ndihmon Këshillit në punën e tij, e këshillon dhe e ndihmon në kryerjen e përgjegjësive të tij, në menaxhimin e gjyqësorit dhe të gjykatave dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit, si dhe është përgjegjës për të gjitha funksionet administrative dhe të hulumtimit që ndërlidhen me përkrahjen e Këshillit, në pajtim me rregulloren e punës së Këshillit.

Këshilli zhvillon dhe miraton rregullore që ndërlidhen me strukturën organizative dhe funksionimin e Sekretariatit. Gjithashtu, Sekretariati i propozon Këshillit politika të reja, rregulla dhe rregullore, kurdoherë që është e nevojshme, për administrimin efikas dhe efektiv të gjykatave, i raporton rregullisht Këshillit për punën e gjykatave dhe ofron rekomandime për përmirësime. Në kuadër të Sekretariatit veprojnë edhe pesë departamente dhe shtatë zyra funksionale.

## ÇËSHTJET E PERSONELIT DHE TË ADMINISTRATËS SË SEKRETARIATIT

Sekretariati si organ qendror kujdeset për menaxhim dhe administrim, për mirëmbajtjen e dosjeve të të gjithë gjyqtarëve dhe stafit tjetër në gjykata. Të gjitha aktivitetet e punës, në kuadër të çështjeve të personelit, i mbështet në dispozitat juridike të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe në rregulloret e miratuara nga Qeveria apo Ministria e Administratës Publike, që rezultojnë nga Ligji. Në ato fusha ku mungojnë rregulloret e reja, mbeten në fuqi udhëzimet e vjetra administrative. Me buxhet të Këshillit janë të lejuara 1483 pozita, për staf mbështetës për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme – 20 pozita, për Zyrën e Prokurorit Disiplinor – 20 pozita dhe për Njësinë për Shqyrtimin e Performancës së Gjyqësorit, 7 pozita.

Me Ligjin për buxhetin e vitit 2011 dhe 2012, numri i pozitave për staf administrativ në gjykata, në Sekretariat dhe në njësitë tjera, ka ngelur i njëjtë, pavarësisht nga ajo se janë kërkuar pozita të reja



për staf administrativ, ato nuk janë lejuar (Pozita për praktikantë, referentë dhe të tjera). Departamenti i Administratës dhe Personelit, krahas nevojave reale dhe kërkesave të parashtruara, ka shpërndarë pozitat sipas nevojave të domosdoshme për funksionimin normal të punës së gjykatave dhe njësive tjera.

Shqetësim që përcillet në vite, është mos lejimi i buxhetit për pozitat e parapara për praktikantë gjyqësorë, për këtë arsye nuk mund të jemi shumë optimistë se në të ardhmen do të kemi kuadër të ri të kualifikuar dhe të përgatitur për të bartur detyrat e punës së bashkëpunëtorit profesional e më vonë edhe të gjykatësit që ka nxitur Këshillin që të fillojë angazhimin e praktikantëve vullnetarë, pa pagesë. Megjithatë, me ndihmën e donatorëve, respektivisht UNDP-së, dy vitet e fundit, Këshilli ka arritur t'i paguajë praktikantët për angazhimin e tyre në gjykata.

Për këtë arsye jemi detyruar të pranojmë praktikantë vullnetarë pa pagesë, por fatmirësisht, dy vitet e fundit, kanë qenë të kompensuar me pagë, falë bashkëpunimit të SKGJK-së me UNDP-në.

Sa i përket disiplinimit të stafit mbështetës, janë iniciuar gjithsej 11 procedura disiplinore ndaj shërbyesve civilë për shkak të dyshimit të supozuar të shkeljes së Kodit të etikës së shërbyesve civilë.

Komisioni Disiplinor ka shqiptuar masa disiplinore për 11 raste dhe atë:

Tre (3) raste me vërejtje me shkrim, tre (3) raste me pezullim nga puna dhe ndalim të 1/3 së rrogës për dy muaj, dy (2) raste me pezullim nga puna me pagesë 50% të rrogës deri në marrjen e ndonjë vendimi nga gjykata, tri (3) raste me ndërprerje të marrëdhënies së punës në administratën gjyqësore.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe akteve tjera nënligjore, për SKGJK-në kanë rezultuar përgjegjësi të reja. Deri më tani, SKGJK ka bërë punë të madhe për harmonizimin e aktiviteteve të punës, konform dispozitave ligjore të aplikueshme, por prapëseprapë kanë ngelur disa aktivitete të pa harmonizuara e që priten të adresohen në muajt në vijim.

## **BUXHETI DHE FINANCA**

SKGJK planifikon, menaxhon dhe ekzekuton buxhetin e Këshillit ku përfshihet buxheti për të gjitha gjykatat e Kosovës dhe Sekretariatit e Këshillit, buxheti për Njësinë e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore, Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Po ashtu, menaxhon procedurat e gjenerimit të të hyrave gjyqësore dhe depozitave gjyqësore nga gjykatat (dënimet e trafikut, dënimet e gjykatave, taksat gjyqësore, kaucionet, depozitat, etj.), pranon raportet nga bankat komerciale dhe gjykatat, i barazon ato, i zbraz në MEF, si dhe i raporton MEF-it dhe KGJK-së. Gjithashtu, pranon, përgatit dhe procedon pagesat (faturat) e shpenzimeve buxhetore nga shërbimet e brendshme të Këshillit sipas planit të shpenzimeve dhe planit të prokurimit për shërbimet, furnizimet dhe punët e kryera nga kontraktorët e Këshillit, si dhe nga të gjitha gjykatat e Kosovës, siç janë pagesat për gjyqtarë laikë, avokatë sipas detyrës zyrtare, ekspertë gjyqësorë, pagesat për rrymë, ujë, mbeturina, ngrohje, telefoni fikse, pulla postare, parat e imëta (petty cash) etj.

## BUXHETI I VITIT 2011

Buxheti i përgjithshëm i Këshillit si organizatë buxhetore dhe katër programet e tij: gjykatat dhe Sekretariatit e Këshillit, Njësinë e Auditimit Gjyqësor, Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, për vitin 2011, sipas Ligjit Nr.04/L-001, ka qenë në shumë 17,000,892 €, (për gjithsej 1929 pozita, prej tyre 399 gjyqtarë dhe 1530 pozita administrative), shprehur në përqindje 1.20 % pjesëmarrja në buxhetin e Kosovës.

Të hyrat gjyqësore, të cilat gjenerohen nga Këshilli, përkatësisht nga gjykatat, Sekretariati dhe Dhoma e Posaçme, për periudhën janar – dhjetor 2011 kapin shumën prej 9,793,920.23 €, përkatësisht 1,085,231.01 € ose 12.46 % më shumë se në vitin 2010.

## RAPORTI I SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT NË VITIN 2011

Kategoritë Ekonomike	Buxheti vjetor 2011 sipas Ligjit Nr.04/L-001	Buxheti i alokuar 2011	Buxheti i zotuar deri më 31.12.2011	Buxheti i shpenzuar deri më 31.12.2011	% e buxhetit të zotuar (4-5)	% e buxhetit të shpenzuar (4-6)
Pagat dhe Mëditjet	10,108,462	10,108,462	9,273,571.05	9,273,571.05	91.74	91.74
Mallrat dhe Shërbimet	4,120,105	3,793,986.67	3,769,590.30	3,449,167.20	99.36	90.91
Shpenzimet Komunale	583.475	462,522.43	462,522.43	413,394.71	100	89.38
Shpenzimet Kapitale	2,188,850	1,844,850	1,844,850	1,111,902.28	100.000	60.27
<b>Gjithsej</b>	<b>17,000,892</b>	<b>16,209,821.10</b>	<b>15,350,533.78</b>	<b>14,248,035.24</b>	<b>94.70</b>	<b>87.90</b>

Në bazë të kërkesave nga Ministria e Financave në muajin korrik dhe gusht lidhur me pezullimin, përkatësisht kursimet e ndonjë projekti janë dërguar dy projekte kapitale për kursim, një projekt për Pajisje të Sigurisë dhe Video Vëzhgimit në shumë prej 100,000 € si dhe projekti i Audio Incizimit në shumë 148,365 €, ndërsa një projekt për pezullim për Dizajnimin dhe Ndërtimin e objektit të Gjykatës në Shtërpcë në shumë prej 244,000 € (250,000 € – 6,000 €).

Ministria e Financave–Departamenti i Thesarit ka pezulluar (shkurtuar) dy projekte atë për Pajisje të

Sigurisë dhe Video Vëzhgimit në shumë prej 100,000 € dhe atë për Ndërtimin e objektit të Gjykatës në Shtërpçë në shumë prej 244,000 €.

Gjithashtu, sipas vendimit të Qeverisë Nr.04/29, datë 27.07.2011 janë reduktuar mjete nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve gjithsej për Këshillin në shumë 247,206.00 € ndërsa sipas programeve të Këshillit si në vijim: Gjykatat dhe Sekretariati: 233,666.00 €, Njësia e Auditimit Gjyqësor: 1,240.00 €, Zyra e Prokurorit Disiplinor: 4,200.00 € dhe Dhoma e Veçantë: 8,100.00 €. Po ashtu, me vendime të veçanta të Qeverisë në fund të vitit 2011 janë bërë shkurtime në mallra dhe shërbime në shumë prej 78,911.33 € dhe në shpenzime komunale në shumë prej 120,952.57€.

Pas këtyre ndryshimeve të lartpërmendura kemi një buxhet vjetor të përgjithshëm në shumë prej 16,209.821.10 € pa të hyra dhe donacione.

Siç shihet në raportet e bashkangjitura ky buxhet është zotuar për periudhën janar – dhjetor 2011 në shumën e përgjithshme 15,350,533.78 €, shprehur në përqindje 94.70 % ndërsa është shpenzuar 14,248,035.24 €, shprehur në përqindje 87.90 %.

Sipas kategorive ekonomike buxheti i përgjithshëm i KGJK-së është zotuar dhe shpenzuar si në vijim:

1. Paga dhe Mëditje: Nga shuma vjetore e buxhetit të aprovuar prej 10,108,462 € janë zotuar dhe shpenzuar 9,273,571.05 €, shprehur në përqindje 91.74 %.
2. Mallra dhe shërbime: Nga shuma vjetore e buxhetit të alokuar prej 3,793,986.67 € janë zotuar 3,769,590.30 € shprehur në përqindje 99.36 %, ndërsa janë shpenzuar 3,449,167.20 €, shprehur në përqindje 90.91 %.
3. Shpenzimet Komunale: Nga shuma vjetore e buxhetit të alokuar prej 462,522.43 € janë zotuar 462,522.43 € shprehur në përqindje 100 %, ndërsa janë shpenzuar 413,394.71 €, shprehur në përqindje 89.38 %.
4. Investimet Kapitale: Nga shuma vjetore e buxhetit të alokuar prej 1,844,850 € janë zotuar 1,844,850 € shprehur në përqindje 100 %, ndërsa janë shpenzuar 1,111,902.28 € shprehur në përqindje 60.27 %. Vlen të theksohet se në realizimin e ultë të shpenzimit nga kjo kategori ka ndikuar shkurtimi i dy projekteve kapitale nga Ministria e Financave (Dizajnimi dhe Ndërtimi i objektit të Gjykatave në Shtërpçë dhe projekti Pajisje të sigurisë dhe video vëzhgimit) si dhe mos realizimi i tri projekteve tjera (Renovimi i objektit të OSBE, Blerja e automjeteve dhe Projekti i Audio Incizimit).

## PROJEKTET TJERA DHE BASHKËRENDIMI ME DONATORË

Këshilli ka filluar me bashkërendimin e aktiviteteve me donatorë, duke mbajtur takime mujore me të gjithë donatorët në sektorin e gjyqësisë. Krahas bashkëpunimit me Programin EROL të USAID, SKGJK gjatë këtij viti ka arritur që të ngushtojë bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë. Rrjedhimisht, janë iniciuar disa projekte:

- Projekti me Qeverinë Norvegjeze për ndihmë në procesin e emërimit të gjyqtarëve.
- Projekti me Komisionin Evropian (TAIEX) dhe Qeverinë Norvegjeze për ndihmë në përpilimin e Strategjisë së TIK.
- Projekti gjithëpërfshirës për ndihmë të Këshillit Gjyqësor të Komisionit Evropian (IPA), të zbatuar nga Human Dynamics.

Janë iniciuar edhe disa diskutime shitesë me donatorë tjerë për projekte të ndryshme në ndihmë dhe ngritje të kapaciteteve të Këshillit.

Nga burimet vetanake SKGJK është në fazën e zbatimit të projektit për Publikimin e Seancave Gjyqësore, me ç'rast të gjitha gjykatat janë pajisur me monitorë ku evidentohen të gjitha oraret e seancave gjyqësore. Po ashtu, ka vazhduar me avancimin e Software-it e Bazës së të Dhënave për të Hyrat Gjyqësore.

## ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR

Zyra e Prokurorit Disiplinor është themeluar si shërbim përgjegjës për inspektim, revizion dhe hetime disiplinore në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës. Zyra e Prokurorit Disiplinor në administrimin e funksioneve të saja, vepron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ZPD-ja është organ i ndarë dhe i pavarur që i shërben si KGJK-së ashtu edhe KPK-së.

Mandati i ZPD-së përfshin hetimin e parashtresave kundër gjyqtarëve, gjyqtarëve laikë dhe prokurorëve dhe paraqet rekomandim për shqiptimin e masave disiplinore ndaj tyre. ZPD respekton pavarësinë e gjyqësorit dhe sistemit prokurorial. ZPD nuk shqyrton parashtresat që kanë të bëjnë me pakënaqësitë kundër vendimeve gjyqësore, si dhe parashtresat abuzive. Inspektori gjyqësor disponon autorizim të plotë për hetim disiplinor, të drejtë për të marrë në pyetje cilindo individ që mund të jap informata relevante dhe të ketë qasje në çfarëdo dokumenti dhe procedurë gjyqësore.

Aktivitetet e ZPD nuk do të shtjellohen në këtë raport pasi që ZPD përgatit raport vetanak vjetor.

## NJËSIA PËR SHQYRTIMIN E PERFORMANCËS GJYQËSORE

Njësia për Shqyrtimin e Performansës së Gjyqësorit (NJSHPGJ) vlerëson punën e gjykatave dhe i propozon Këshillit politika, apo udhëzime për reformimin apo përmirësimin e punës së gjykatave. NJSHPGJ, duke audituar të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, ka për qëllim të shqyrtojë zbatimin e ligjit, respektimin e të drejtave të palëve, identifikimin e zbrazëtirave ligjore dhe pengesave që paraqiten në ushtrimin e funksioneve gjyqësore si dhe identifikimin e praktikave të mira.

Mandati i NJSHPGJ është furnizimi i Këshillit me analiza, vlerësime, rekomandime, këshilla dhe informata në lidhje me aktivitetet e shqyrtuara, me anë të të cilave do të promovohet kontrolli efektiv me kualitete të larta profesionale të të punësuarve, në kohë dhe me para të arsyeshme.

Në vitin 2011 NJSHPGJ ka qenë e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, aktivitetet e së cilës do të shtjellohen më poshtë. Për më tepër, sipas propozimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe kërkesës së Kryesuesit të KGJK-së, NJSHPGJ, prej fillimit të muajit nëntor 2011e për të vazhduar edhe gjatë vitit 2012, sipas angazhimit *'ad hoc'* ka punuar në një auditim të performancës gjyqësore me temë "Rishikimi i procesit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe dënim me gjobë të lëndët e pa ekzekutuara dhe të parashkruara/pezulluara" për fushë-veprimtarinë e performancës prej fillimit të vitit 2000 deri më 30 qershor 2011.

# PROCESI I EMËRIMIT TË GJYQTARËVE

---

Procesi i emërimit të gjyqtarëve ka qenë një ndër proceset më me rëndësi të veçantë për tërë gjyqësorin e Kosovës.

Më 15 shtator 2010 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial – Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në përpjekje të bashkëpunimi të plotë dhe gjithëpërfshirës në procesin e verifikimit, në mënyrë që emërimet e ardhme të gjyqtarëve dhe prokurorëve të bëhen në bazë të meritave. Ky proces mbështetet nga Zyra për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor (ZVVGJ) e themeluar me Rregulloren mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, e cila është përgjegjëse për zbatimin e drejtë dhe korrekt të vlerësimit profesional dhe verifikimit të gjerë të biografisë së kandidatëve që aplikojnë për pozitat e gjyqtarëve.

ZVVGJ-ë në fillim të vitit 2011 filloi të pranojë aplikacionet paraprake për kandidatët të cilët me sukses kanë kaluar provimin e Kodit të Etikës, të mbajtur më 16 tetor 2010, organizuar nga KPGJP-ja. Gjerë më 28 shkurt 2011, në afatin e paraparë për aplikim, aplikacionet e tyre preliminare, me mundësi aplikimi për tri pozita të dëshiruara në gjyqësor, i kanë dërguar gjithsej – 445 kandidatë, që në total përfshihen 815 pozita.

Këshilli, në pajtim me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 1.6 dhe 6 të Rregullores së UNMIK–ut nr. 2005/52, nenin 3 (a) të Rregullores së UNMIK–ut nr. 1999/5, nenin 6.2 të Rregullores së UNMIK–ut nr. 2000/57, Rregullores së UNMIK–ut nr. 2008/4, nenin 3 të Urdhëresës Administrative të UNMIK–ut nr. 2008/6 dhe të Rregullores për Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, shpall 112 vende të lira pune për gjyqtarë. Deri në paraqitjen e këtij raporti, janë plotësuar 12 vende të lira pune:

Gjatë vitit 2011 janë plotësuar pozitat e lira si në vijim:

## **Gjykata Supreme e Kosovës , 6 pozita të lira.**

Kandidatë të mundshëm për këto pozita kanë qenë gjithsej 35, nga të cilët, në Gjykatën Supreme të Kosovës, janë emëruar 6 gjyqtarë.

## **Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, 4 pozita të lira.**

Kandidatë të mundshëm për këto pozita kanë qenë gjithsej 36, nga të cilët, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, janë emëruar 4 gjyqtarë.

**Gjykata Ekonomike, 2 pozita të lira.**

Kandidatë të mundshëm për këto pozita kanë qenë gjithsej 34, prej të cilëve 2 kandidatë janë emëruar gjyqtarë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut.

**Gjykatat në nivel të qarqeve, 15 pozita të lira.**

Kandidatë të mundshëm për këto pozita kanë qenë gjithsej 135, prej të cilëve 98 i kanë plotësuar kushtet për t'iu nënshtruar fazës së verifikimit dhe vlerësimit profesional, të ftuar në intervistë pas dorëheqjes së kandidatëve individualë kanë qenë 73.

**Gjykatat në nivel komunal, regjioni i Prishtinës ka gjithsej 42 pozita të lira.**

Kandidatë të mundshëm për këto pozita kanë qenë gjithsej 155, prej të cilëve 97 i kanë plotësuar kushtet për t'iu nënshtruar fazës së verifikimit dhe vlerësimit profesional.

# STRATEGJIA SHETËRORE PËR REDUKTIMIN E LËNDËVE TË VJETRA

---

Bazë për zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra Gjyqësore ishte pika 5 e Planit Strategjik të Gjykatave të Kosovës 2007–2012, e miratuar nga Këshilli sipas Aktvendimit nr. 22/2010 të datës 18 nëntor 2010.

Këshilli, për të realizuar pikën 5 të Planit Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës 2007–2012, pas shumë angazhimesh, themeloi grupin dhe nëngrupet punuese për identifikimin e aktiviteteve praktike, se ç'duhet ndërmarr për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra Gjyqësore. Për këtë, Këshilli, në mbledhjen e datës 11 nëntor 2010 dhe sipas Aktvendimit nr. 22/2010 të datës 18 nëntor 2010, miratoi Plan Strategjinë për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra Gjyqësore, duke filluar së zbatuari nga 1 janari 2011, për të përfunduar gjer më 31 dhjetor 2012. Njëkohësisht, Këshilli, në të njëjtin vendim caktoi detyra për zbatim të këtij Aktvendimi. Për zbatimin e këtij Aktvendimi, Këshilli, përcaktoi koordinatorin, të angazhuarit, monitoruesit dhe kapacitetet disiplinuese.

Për arritjen e objektivit kryesor të Strategjisë Shtetërore në Reduktimin e Lëndëve të Vjetra Gjyqësore dhe në realizimin e objektivave ndihmëse, ishin të angazhuar:

Këshilli, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), Gjykatat, USAID/SEAD – Iniciativë e veçantë për përmbarim të lëndëve nga lëmia civile. EULEX, përmes këshilltarëve për Këshillin, ishte angazhuar si monitorues dhe këshillëdhënës nëpër takime të ndryshme që kishin të bënin me zbatimin e Strategjisë.

Të gjitha gjykatat kanë caktuar personin kontaktues, janë mbajtur tre (3) takime me Këshillin Konsultues për Zbatim të Strategjisë, është mbajtur takim informativ me të gjithë kryetarët e gjykatave. Për progresin e arritur në zbatim të Strategjisë, Këshilli ka raportuar katër (4) herë për tre (3) mujorët e vitit 2011, janë mbajtur 3 (tre) konferenca për shtyp lidhur me progresin e arritur në zbatim të Strategjisë, kumulativisht për nëntë (9) mujorin e arritur në progres është prezantuar para Këshillit, me të gjithë kryetarët dhe me tetë (8) administratorët e gjykatave të Kosovës është mbajtur konferencë e Këshillit lidhur me të arriturat dhe pengesat në zbatim të Strategjisë dhe, anëtarët e Njesisë për Shqyrtim të Performancës Gjyqësore, për 12 muaj angazhim i kanë pranuar dhe përpunuar të dhënat nga terreni dhe kanë bërë 136 vizita ndihmëse–bashkëpunuese në gjykatat në terren. Janë draftuar:

Rregullorja për vlerësimin e punës së gjyqtarëve;

Të gjitha Memorandumet me institucionet relevante të cilat do të ndihmonin gjyqësorin në kryerje më të shpejtë të lëndëve gjyqësore, siç janë:



Zyra e Regjistrimit Civil, Policia e Kosovës, PTK, Agjencioni Kadastral i Kosovës, me MTI-Zyra e Regjistrimit të Bizneseve dhe Banka Qendrore e Kosovës si dhe Formulari për padi civile, i cili do t'i ndihmonte palët dhe gjykatën për një formë të unifikuar.

Janë miratuar:

Rregullorja për caktimin e normave të detyrueshme për gjyqtarë, është bërë rekrutimi për pozita të bashkëpunëtorëve profesionalë ( në pozitat e lira), rekrutimi për pozita të juristëve praktikantë, rekrutimi i 30 pozitave për nëpunës përmbarimorë sipas programit të USAID/SEAD-it.

Nga raporti statistikor i SKGJK-së është eliminuar numri i lëndëve të pa kryera gjyqësore, i lëndëve që paraqesin paushallin dhe shpenzimet gjyqësore.

TI- ve e SKGJK ka përgatitur projektin për regjistrimin elektronik të të gjithë personave që janë në evidencë nga baza e kryerjes së çdo veprë penale, veprim i cili do të ndihmonte sigurimin e informacionit të saktë dhe të shpejtë, kryesisht lidhur me lëshimin e certifikatave se janë, apo nuk janë në ndjekje penale.

### **Të arriturat në kryerjen e lëndëve të vjetra gjyqësore**

Mund të konsiderohet se, deri në këtë periudhë raportuese, zbatimi i Strategjisë ka vijuar dhe është realizuar, përafërsisht, sipas planit.

Gjykatat të cilat e kanë tejkaluar planin e punës në reduktim të lëndëve të vjetra janë Gjykata Supreme e Kosovës, me shkallë realizuese 59,96% dhe gjykatat komunale për kundërvajtje me shkallë realizuese me 85,17%. Gjykata, të cilat kanë ngecur në realizimin e planit, sipas faktorit kohë, janë gjykatat e qarkut, me realizim të përgjithshëm prej 31,47%, gjykatat komunale me 28,71% dhe Gjykata Ekonomike e Qarkut me 5,79 %.

E veçuar e Gjykatës Ekonomike të Qarkut është se të gjitha lëndët e pa kryera i takojnë procesit të ekzekutimit/përmbarimit, ndërsa në procedurë kontesti nuk ka asnjë lëndë të pa vendosur.

Kur llogariten 4 periudha tremujore të vitit 2011, përqindja prej 6,71 % të lëndëve të kryera gjatë periudhës së katërt (4/8) plus 5,48 % e lëndëve të kryera gjatë periudhës së tretë raportuese (3/8), plus 19,18 % e lëndëve të kryera gjatë periudhës së dytë raportuese (2/8), plus 10,84 % e lëndëve të kryera gjatë periudhës së parë raportuese (1/8), del se gjyqësori i Kosovës prej 1 janarit 2011– deri më 31 dhjetor 2011 ka kryer gjithsej 42,21 % nga numri i përgjithshëm i lëndëve të vjetra.

Në këtë fazë raportuese, ky reduktim i lëndëve është i kënaqshëm, përkundër ngecjeve në disa segmente gjyqësore, të cilat nuk varen shumë nga pozita/angazhimi i drejtpërdrejtë i gjyqtarit. P.sh. numri prej 54.973 lëndësh të pa kryera i takon grup lëndëve përmbarimore, ku rreth 90 % të këtyre lëndëve janë kërkesa përmbarimore nga dokumenti autentik. Sikur numri prej 54.973 lëndësh të zbritet nga numri i 99.798 i lëndëve të mbetura për t'u kryer gjatë vitit 2012, del se angazhimi i gjyqtarëve për vitin 2012 do të jetë për të vendosur në 44.825 lëndë gjyqësore. Nëse numri 44825 pjesëtohet me 300 gjyqtarë, del se për ta përmbushur strategjinë në tërësi, çdo gjyqtar duhet të vendosë për 150 lëndë brenda vitit 2012.

Vijon treguesi i përgjithshëm tabelar mbi të dhënat realizuese shprehu) në përqindje të lëndëve të kryera gjatë muajve të vitit 2011 (1/8, 2/8, 3/8 dhe 4/8), respektivisht rezultati i tërësishëm ( i të gjitha gjykatave) prej 1 janarit 2011 deri 31 dhjetor 2011, si dhe numri i lëndëve të mbetura për t'u kryer gjatë vitit 2012:

Nr.	Gjykatat	I/2011	II/2011	III/2011	IV/2011	2011
1.	Gj. S.e Kosovës	12,00 %	18,56 %	11,94 %	17,46 %	59,96 %
2	Gjykatat e Qarkut	12,24 %	8,75 %	4,53 %	5,95 %	31,47 %
3	Gj.E.e Qarkut	0,60 %	4,13 %	0,15 %	0,91 %	5,79 %
4.	Gj. Komunale	6,37 %	8,96 %	5,69 %	7,69 %	28,71 %
5.	Gj.K.për Kund.	23,00 %	55,50 %	5,12 %	1,55 %	85,17 %
6.	Në përgjithësi	<b>10,84 %</b>	<b>19,18 %</b>	<b>5,48 %</b>	<b>6,71 %</b>	<b>42,21 %</b>

Vijon treguesi i përgjithshëm tabelor mbi të dhënat e numrit të lëndëve të inventarizuara (të gjetura nëpër gjykata si lëndë të pa kryera më 31.12.2010) të cilat ishin më të vjetra apo të regjistruara prej vitit 2000 deri më 31.12.2008, numri i lëndëve të kryera gjatë katër tre muajorëve të vitit 2011 (1/8, 2/8, 3/8 dhe 4/8), respektivisht rezultati i tërësishëm ( i të gjitha gjykatave) prej 1 janarit 2011 deri 31 dhjetor 2011, si dhe numri i lëndëve të mbetura për t'u kryer gjatë vitit 2012:

Nr.	Gjykatat	Lëndët e inventarizuar	Nr. i lëndëve të kryera gjatë vitit 2011					Lëndë të mbetura për 2012	
			I/2011	II/2011	III/2011	IV/2011	2011		
1.	Gj.S. Kosovës	544	108	101	65	95	369	175	
2	Gj. e Qarkut	2720	333	238	103	162	836	1884	
3	Gj.E. Qarkut	653	4	27	1	6	38	615	
4.	Gj. Kom.	123443	6089	8746	7031	9505	31371	92106	
5.	Gj.K. për K.	33912	7804	18824	1737	529	28894	5018	
6.	<b>Në përgjithësi</b>	<b>161273</b>	<b>14388</b>	<b>27936</b>	<b>8937</b>	<b>10297</b>	<b>61508</b>	<b>99798</b>	

### Ngecjet në kryerjen e lëndëve të vjetra gjyqësore

Gjykata më të ngecura, e të cilat kanë raportuar rregullisht, janë gjykatat e Mitrovicës, të cilat fizikisht veprojnë në Vushtri, por që nuk kanë pasur mundësi për të paraqitur në inventarizim numrin e lëndëve më të vjetra se muaji mars i vitit 2008, ngase materia gjyqësore gjendet në objektin e<sub>18</sub>

gjykatave në qytetin e Mitrovicës. Gjithashtu, gjykatat në Zubin Potok dhe në Leposaviq, nuk janë të përfshira në këtë Strategji.

Gjykata më të ngecura apo me numër më të vogël të lëndëve të kryera, janë gjykatat e qarkut, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përkundër që ka numër më të madh të lëndëve gjyqësore, është treguar mjaftë e suksesshme. Nga gjykatat komunale, të cilat kanë ngecur në raport me të tjerat, dallohen Podujeva, Dega në Shtërpçë, Dragashi dhe Mitrovica. Përveç Podujevës, e veçuar e këtyre gjykatave është se nuk kanë numër të madh të lëndëve për përmbushje të Strategjisë. Nga gjykatat komunale për kundërvajtje të cilat nuk e kanë përmbushur Strategjinë janë gjykata e Glllogcit dhe e Klinës.

Gjykata Supreme e Kosovës dhe gjykatat komunale për kundërvajtje, plotësisht e kanë përmbushur Planin Strategjik, ndërsa gjykatat e qarkut dhe gjykatat komunale nuk e kanë arritur shkallën realizuese mbi 40%.

Krahasuar me numrin e gjyqtarëve, në veçanti të gjykatave komunale, është arritur progres i kënaqshëm në lëndët e lëmisë penale, ndërsa në lëndët e lëmisë civile do të duhej angazhim edhe më i shtuar se sa ai që ishte gjatë vitit 2011.

Rezultat të pakënaqshëm kanë treguar gjykatat komunale në lëndët e lëmisë së ekzekutimit të sanksioneve penale dhe përmbarimet/ekzekutimet civile (kryesisht tek dokumentet autentike), pjesë e punës, e cila kryesisht është e lidhur me stafin administrativ të gjykatës (nëpunësve përmbarimorë).

# STRUKTURA E GJYKATAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Sa i përket strukturës së gjykatave, kemi:

- Gjykata Supreme të Kosovës,
- Gjykata e specializuar për privatizim, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme,
- Gjykatat e qarkut, pesë (5),
- Gjykata ekonomike, një (1),
- Gjykatat komunale, njëzet e katër (24), me dy degë, në Graçanicë dhe Shtërpçë, Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, një (1) dhe gjykatat komunale për kundërvajtje, njëzet e pesë (25).



Tabela I. Struktura e gjyqtarëve në disa gjykata

Numri i gjykatave	GJYKATAT	Numri i gjyqtarëve sipas gjykatave	Gjinia		Përkatësia kombëtare				
			Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serb	Boshnjak	Turk	R/E/A/G
1	Gjykata Supreme e Kosovës	16	8	8	14	1		1	
1	Dhoma e Veçantë e Gjy. Supreme	3	3		3				
	Paneli Ankues i Agje. Kosovar të Pronës në Gjykatën Supreme	1	1		1				
1	Gjykata Ekonomike	3	1	2	3				
1	Gjykata e Lartë për Kundërvajtje	5	3	2	5				
4	<b>Totali në Gjykatat e veçanta</b>	<b>28</b>	<b>16</b>	<b>12</b>	<b>26</b>	<b>1</b>		<b>1</b>	
Numri i gjykatave	GJYKATAT	Numri i gjyqtarëve sipas gjykatave	Gjinia		Përkatësia kombëtare				
			Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serb	Boshnjakë	Turk	R/E/A/G
1	Gjykata e Qarkut Prishtinë	14	8	6	13		1		
1	Gjykata e Qarkut Prizren	8	5	3	6		2		
1	Gjykata e Qarkut Pejë	10	8	2	9				1
1	Gjykata e Qarkut Gjilan	6	6		5	1			
1	Gjykata e Qarkut Mitrovicë	7	6	1	6	1			
5	<b>Totali në gjykatat e qarkut</b>	<b>45</b>	<b>33</b>	<b>12</b>	<b>39</b>	<b>2</b>	<b>3</b>		<b>1</b>

Tabela II. Struktura e gjyqtarëve në gjykatat komunale

Numri i gjykatave	GJYKATAT	Numri i gjyqtarëve sipas Gjykatave	Gjinia		Përkatësia kombëtare				
			Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serb	Boshnjak	Turk	R/E/A/G
1	Gjykata Komunale Prishtinë	26	12	14	25		1		
	GJK-Prishtinë-Dega në Graçanicë	1	1			1			
1	Gjykata Komunale Podujevë	2	2		2				
1	Gjykata Komunale Lipjan	4	4		4				
1	Gjykata Komunale Gllgovc	2	2		2				
1	Gjykata Komunale Ferizaj	7	6	1	7				
	GJK- Ferizaj - Dega në Shtërpçë	1	1		1				
1	Gjykata Komunale Kaçanik	2	2		2				
1	Gjykata Komunale Prizren	11	8	3	10		1		
1	Gjykata Komunale Suharekë	4	4		4				
1	Gjykata Komunale Rahovec	4	4		4				
1	Gjykata Komunale Malishevë	3	3		3				
1	Gjykata Komunale Dragash	2	1	1	2				
1	Gjykata Komunale Pejë	10	6	4	10				
1	Gjykata Komunale Gjakovë	8	6	2	8				
1	Gjykata Komunale Klinë	1	1		1				
1	Gjykata Komunale Istog	3	3		3				
1	Gjykata Komunale Deçan	4	3	1	4				
1	Gjykata Komunale Gjilan	9	9		9				
1	Gjykata Komunale Viti	4	3	1	4				
1	Gjykata Komunale Kamenicë	3	3		3				
1	Gjykata Komunale Mitrovicë	4	3	1	4				
1	Gjykata Komunale Skënderaj	2	2		2				
1	Gjykata Komunale Vushtrri	1		1	1				
1	Gjykata Komunale Leposaviq	1	1			1			
1	Gjykata Komunale Zubin Potok								
24	<b>Totali në gjykatat komunale</b>	<b>119</b>	<b>90</b>	<b>29</b>	<b>115</b>	<b>2</b>	<b>2</b>		

Tabela III. Struktura e gjyqtarëve në gjykatat komunale për kundërvajtje

Numri i gjykatave	GJYKATAT	Numri i gjyqtarëve sipas Gjykatave	Gjinia		Përkatësia kombëtare				
			Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serb	Boshnjak	Turq	R/E/A/G
1	Gj. K. për Kundërvajtje Prishtinë	7	3	4	7				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Podujevë	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Lipjan	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Glogovc	2	2		2				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Ferizaj	2	1	1	2				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Shtërpçë	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Kaçanik	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Prizren	9	8	1	8		1		
1	Gj. K. për Kundërvajtje Suharekë	2	1	1	2				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Rahovec	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Malishevë	2	2		2				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Dragash	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Pejë	5	4	1	5				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Gjakovë	2		2	2				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Klinë	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Istog	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Deçan	2	1	1	2				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Gjilan	3		3	3				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Viti	3	3		3				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Kamenicë	2	2		2				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Mitrovicë	1		1	1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Skënderaj	1	1		1				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Vushtrri	3	3		3				
1	Gj. K. për Kundërvajtje Leposaviq								
1	Gj. K. për Kundërvajtje Z. Potok	1		1		1			
<b>25</b>	<b>Totali në Gjy. Ko. për Kundërvajtje</b>	<b>55</b>	<b>39</b>	<b>16</b>	<b>53</b>	<b>1</b>	<b>1</b>		
Numri i gjykatave		Numri i gjyqtarëve sipas gjykatave	Gjinia		Përkatësia kombëtare				
			Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serbë	Boshnjakë	Turq	R/E/A/G
<b>58</b>	<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>247</b>	<b>178</b>	<b>69</b>	<b>233</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>1</b>	<b>1</b>

Fig. 1 Tabela e strukturës sipas gjinisë





Fig. 2 Tabela e strukturës sipas nacionalitetit





# GJENDJA ME LËNDË NË GJYKATA

Gjendja më lëndë në të gjitha gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2011 ka qenë:

- 295,842 lëndë në punë, prej tyre:
- 209,448 lëndë të trashëguara, pra, nga periudha paraprake,
- 86,394 lëndë të pranuar,
- 82,805 lëndë të zgjidhura dhe
- 213,037 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura në fund të vitit 2011.


Gjendja më lëndë për secilin nivel të gjykatave të rregullta të republikës së Kosovës gjatë vitit 2011

Gjykata Supreme e Kosovës ka pasur 7,033 lëndë në punë

## Struktura e lëndëve në punë:

- 36.66 % Administrative "A",
- 17.5 % Revizion "REV" dhe REV II"
- 12.7 % Ankesa Penale
- 10.6 % Propozim për vazhdimin e paraburgimit dhe ankesa kundër aktvendimit "APM"
- 8.72 % Ekonomike "AE"
- 13.91 % përkasin lëndëve tjera

*(shikoni paraqitjen grafike në vijim)*



Prej tyre:

- 2938 lëndë të trashëguara, pra, nga periudha paraprake,
- 4095 lëndë të pranuar,
- 3611 lëndë të zgjidhura dhe

- **3422** lëndë kanë mbetur të pazgjidhura në fund të vitit 2011.

Lëndët e pazgjidhura në vitin 2011 (**3422**) është rritur numri për **16.47 %** krahasuar me vitin 2010 (**2938**), mirëpo në vitin 2011 kemi lëndë më shumë të pranuar, **13.89 %** ose **569** lëndë më shumë se në vitin 2010.

Gjykata Ekonomike e Qarkut ka **3175** lëndë në punë

Prej tyre:

- **1947** lëndë të trashëguara, pra, nga periudha paraprake,
- **1228** lëndë të pranuar,
- **704** lëndë të zgjidhura dhe
- **2471** lëndë kanë mbetur të pazgjidhura në fund të vitit 2011.


Në fund të vitit 2011 kësaj gjykate i kanë ngelur të pazgjidhura **2471** lëndë ose (**26.91%**) më shumë krahasuar me vitin paraprak 2010 (**1947**), pavarësisht që në vitin 2011 kemi lëndë më pak të pranuar -2.12 % ose 26 lëndë më pak se në vitin 2010.

Gjykatat e qarkut kanë 21,693 lëndë në punë

**Struktura e lëndëve në punë:**

- **27.49 %** Civile II,
- **21.79 %** Penale I,
- **15.17 %** Civile I, ,
- **12.31 %** Konfirmim të Aktakuzës
- **11.11 %** Penale II dhe
- **12.14 %** i përkasin lëndëve tjera

*(shikoni paraqitjen grafike në vijim)*



Prej tyre:

- **9908** lëndë të trashëguara, pra, nga periudha paraprake,
- **11785** lëndë të pranuar,
- **11262** lëndë të zgjidhura dhe
- **10431** lëndë kanë mbetur të pazgjidhura në fund të vitit 2011.

Lëndët e pazgjidhura në vitin 2011 (**10431**) është rritur numri për **5.3 %** krahasuar me


vitin 2010 (9908), mirëpo në vitin 2011 kemi lëndë më shumë të pranuar, **10.99 %** ose **1291** lëndë më shumë se në vitin 2010.

Gjykatat komunale kanë **263941** lëndë në punë

Struktura e lëndëve në punë:

- **32.68 %** Ekzekutime civile me dokumente autentike ,
- **24.95 %** Lëndë Civile
- **19.57 %** Penale e shkallës së I-rë ,
- **6.27 %** Ekzekutimet penale
- **16.53 %** i përkasin lëndëve tjera

*(shikoni paraqitjen grafike në vijim)*



*Prej tyre:*

- **194655** lëndë të trashëguara, pra, nga periudha paraprake,
- **69286** lëndë të pranuar,
- **67228** lëndë të zgjidhura dhe
- **196713** lëndë kanë mbetur të pazgjidhura në fund të vitit 2011.

Lëndët e pazgjidhura në vitin 2011 (196713) është rritur numri për 1.1 % krahasuar me vitin 2010 (194655), pavarësisht që në vitin 2011 kemi lëndë më pak të pranuar, 0.5 % ose 359 lëndë më pak se në vitin 2010.

Gjendja më lëndë në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje dhe në gjykatat komunale për kundërvajtje të Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2011 ka qenë:


Gjykata e Lartë për Kundërvajtje ka 1697 lëndë në punë dhe 1697 lëndë të zgjidhura.

Gjykatat komunale për kundërvajtje kanë 361192 lëndë në punë.

Struktura e lëndëve në punë:

- **91.46 %** Kundërvajtje nga Komunikacioni ,
- **5.79 %** Kundërvajtje nga Ekonomia,
- **2.18 %** Rendi dhe Qetësia Publike ,
- **0.57 %** Kundërvajtje tjera

*(shikoni paraqitjen grafike në vijim)*



*Prej tyre:*

- **95067** lëndë të trashëguara pra nga periudha paraprake,
- **266125** lëndë të pranuar,
- **252052** lëndë të zgjidhura dhe
- **109140** lëndë kanë mbetur të pazgjidhura në fund të vitit 2011.

Lëndët e pazgjidhura në vitin 2011 (**109140**) është rritur për **14.80 %** krahasuar me vitin 2010 (**95067**), mirëpo në vitin 2011 kemi lëndë më shumë të pranuar 10.25 % ose 27280 lëndë më shumë se në vitin 2010.